



**KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS**

**I.Numër: 463/01-98126, dt: 30 Dhjetor 2024**

Në bazë të nenit 12 par.2 pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-40 të datës 20 shkurt 2008 në mbështetje të nenit 17 të Ligjit nr. 06/L-092 mbi dhënien në shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës Komunale, nenit 17 të rregullores (QRK) Nr.09/2020 për përcaktimin e Procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës si dhe nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4 të Statutit Nr.01/2020 të Komunës së Pejës, I. Numër: 01-016/01-413431.dt.30. shtator 2020, pasi shqyrtoj propozimin e Kryetarit të Komunës, me rekomandim të Komitetit për Politik dhe Financa, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur me datë: 30 Dhjetor 2024, nxjerr këtë:

**VENDIM**

**Nr. 82/2024**

**Mbi formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme Komunale – katin e III-të të Poliklinikës Stomatologjike**

- MIRATOHET** - Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës.
- Komisioni vlerësues sipas këtij vendimi përbehet prej 5 (pesë) anëtarëve si me poshtë:
  - Mentor Bajri anëtarë i kuvendit nga subjekti LDK, anëtarë,
  - Rajan Arapi anëtarë i kuvendit nga subjekti PDK, anëtarë,
  - Edonjeta Berisha – anëtar nga ekzekutivi i komunës - Drejtoreshë për Punë Inspektuese,
  - Diellëza Berisha – anëtar nga ekzekutivi i komunës – Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa,
  - Fitore Haxhihasani anëtarë nga sektori joqeveritar anëtarë.
- Kryesuesi i Komisionit vlerësues zgjidhet me shumicë votash nga radhët e anëtarëve të Komisionit Vlerësues.
- Detyrë dhe përgjegjësi e Komisionit Vlerësues janë: përpilimi i njoftimi publik me të dhënat për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës, prezenca në ankand publik, hapja e ofertave, vlerësimi final i ofertave në pajtim me kriterët e përcaktuara me njoftimin për ankand publik dhe shprehje të interesit, si dhe përgjegjësi tjera të përcaktuara me ligjin dhe rregullore në fuqi.
- Dërgimi të Kryetari i Komunës për miratim të ofertës së përzgjedhur për dhënien afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës dhe çështje tjera të cilat konsiderohen të rëndësishme nga Komisioni vlerësues.
- Administrata e Komunës i ofronë përkrahje komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës Komunale.
- Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Kryetari i Komunës.

8. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe 7 (shtatë) pas publikimit në web faqen e Komunës së Pejës.

**Vendimi ti dërgohet:**  
MAPL-së,  
Kryetarit të Komunës,  
DÇPJ,  
Arkiv.

